



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR PROJEKTVENDIM
PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DEVOLL, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT “BASHKË FITOJMË”, Z. VLADIMIR IVANER KELLO

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 2739 prot., datë 6.9.2023, Këshilli i Bashkisë Devoll, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Edmond Niko Haxhi, propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për Këshillin e Bashkisë Devoll, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 5, z. Vladimir Ivaner Kello.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 29 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Vladimir Ivaner Kello, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Vladimir Ivaner Kello.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10249/1 prot., datë 10.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Devoll, z. Vladimir Ivaner Kello, ku konstatohet se kandidati ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile, konkretisht rubrikën e emrit nga “Qahja” në “Kello”.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 12416/1 prot., datë 9.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Vladimir Ivaner Kello, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Vladimir Ivaner Kello, në Këshillin e Bashkisë Devoll, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Valbona BALLGJINI - Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DEVOLL, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT "BASHKË FITOJMË", Z. VLADIMIR IVANER KELLO

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2739 prot., datë 6.9.2023, Këshilli i Bashkisë Devoll, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Edmond Niko Haxhi, propozuar nga Koalicioni "Bashkë Fitojmë".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e koalicionit "Bashkë Fitojmë", për Këshillin e Bashkisë Devoll, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 5, z. Vladimir Ivaner Kello.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për

zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 29 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Vladimir Ivaner Kello, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, me shkresën nr. 7025 prot., datë 28.9.2023 ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 7026 prot., datë 28.9.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Vladimir Ivaner Kello.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10249/1 prot., datë 10.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Devoll, z. Vladimir Ivaner Kello, ku konstatohet se kandidati ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile, konkretisht rubrikën e emrit nga “Qahja” në “Kello”.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 12416/1 prot., datë 9.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Vladimir Ivaner Kello, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Vladimir Ivaner Kello, në Këshillin e Bashkisë Devoll, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidatin nga lista shumemërore të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Vladimir Ivaner Kello.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI